



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

Kabineti i Ministres së Drejtësisë -Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 315 /2022

Datë 08 / 11 /2022

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 11 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 (nën paragrafi 1.4) të Rregullores QRK-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK)-Nr.04/2021 dhe Rregulloren (QRK)-Nr. 03/2022, si dhe në pajtim me nenin 323 paragrafi 1, nenin 328 paragrafi 1 dhe nenin 330 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-118, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR EMËRIMIN E PËRMBARUESIT PRIVAT**

1. **Z. Astrit (Jakup) Restelica**, emërohet përmbartues privat për territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj.
2. Selia e të emëruarit do të jetë e vendosur brenda territorit të Gjykatës Themelore në Ferizaj.
3. I emëruari, para caktimit të ditës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbartuese në pajtim me paragrafin 4 të nenit 331 të Ligjit për Procedurën përmbartimore, është i obliguar që në afat prej 60 ditësh nga dita e dhënies së betimit të ofroj dëshmitë se i plotëson kushtet sipas nenit 332 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Komisioni për vlerësimin e kandidateve për përmbartues privat, me datë 01.11.2022 ka mbajtur takimin për vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve për emërim për përmbartues privat në territorin e gjykatave themelore në Republikën e Kosovës.

Komisioni vlerësues pas vlerësimit të aplikacioneve dhe dokumentacionit të kandidateve ka përpiluar listën me propozime, dhe duke pasur parasysh se për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pasur më shumë kandidatë për përmbarues, Komisioni duke u bazuar në nenin 329 (paragrafi 2), i cili përcakton se: “*Me rastin e përzgjedhjes në mes të më shumë kandidateve posaçërisht do të merret parasysh rezultati i tyre në provimin për përmbarues privat*”, meqenëse kandidati tjetër ka pasur rezultat më të mirë në provim për përmbarues privat, Komisioni vlerësues ka rekomanduar që Ju të ushtroni veprimtarinë përmbaruese për territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në piken 1 të dispozitivit të këtij vendimi.



**Udhëzimi juridik:** Kundër këtij vendimi mund të ngritët konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

*Vendimi i dërgohet:*

- *Përmbaruesit privat të emëruar;*
- *Odës së Përmbaruesve Privat;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.*